



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial
Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në përputhje me nenin 4 i Ligjit Nr.03/L-224 mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 22 prill 2016, miraton:

RREGULLORE NR.04/2016
PËR BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL

Neni 1
Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton detyrimin e Prokurorit të Shtetit në njoftimin e institucioneve publike kur ndaj punonjësve të tyre ka filluar procedura penale.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje do të zbatohen për të procedurën penale që lidhen me nenin 69 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 73 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës lidhur me të punësuarit në sektorin publik.

Neni 3
Definicionet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore do të kenë kuptimet në vijim:

"Procedurë Penale..."	nënkupton definicioni kodit procedurës penale
"KPP"	nënkupton Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës
"KP"	nënkupton Kodin Penal të Republikës së Kosovës
"Ditë"	nënkupton ditët e punës
"KGjK"	nënkupton Këshilli Gjyqësor i Kosovës
"KPK"	nënkupton Këshilli Prokurorial i Kosovës

Neni 4
Zbatimi i procedurës së brendshme së njoftimit

1. Të gjithë prokurorët e njoftojnë Kryeprokurorin e tyre përkatës, i cili do të njofton Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit në rast të:

- 1.1. Ngritjes së aktakuzës ndaj një shërbyyesi civil në lidhje me ushtrimin e detyrës së atij punonjësi, pavarësisht nëse është bërë njoftimi sipas paragrafit 1.2 të këtij neni;
 - 1.2. Fillimit të procedurës penale ndaj një shërbyyesi civil për veprën penale që lidhet me ushtrimin e detyrës të atij punonjësi;
 - 1.3. Fillimit të procedurës penale ndaj një shërbyyesi civil kur prokurori vlerëson se prania e atij punonjësi mund të dëmtojë hetimet;
 - 1.4. Fillimit të procedurës penale ndaj një punonjësi i cili është subjekt i nenit 73 i Ligjit të Punës, nëse:
 - 1.4.1. Punonjësi është punonjës në sektorin publik siç përkufizohet me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-212 dhe
 - 1.4.2. Procedura ka të bëjë më ushtrimin e detyrës zyrtare të punonjësit.
 - 1.5. Fillimit të procedurës penale ndaj një gjyqtari apo gjyqtari porot pavarësisht natyrës së akuzës;
 - 1.6. Ngritja e aktakuzës ndaj një gjyqtari apo gjyqtari porot pavarësisht natyrës e akuzës dhe pavarësisht nëse është bërë njoftimi sipas paragrafit 1.5 të këtij neni.
2. Njoftimi i kërkuar sipas nenit 4 do të përfshijë dokumentet si në vijim:
- 2.1. kopje të çfarëdo dokumenti relevant zyrtar.
 - 2.2. Emrin e prokurorit të çështjes dhe prokurorinë/departamentin në të cilin punon;
 - 2.3. Emrin e institucionit ku punonjësi është i punësuar, përfshirë edhe funksionin e tij nëse është i ditur; dhe
 - 2.4. Një përshkrim i shkurtër përse prokurori vlerëson se rrezikohet integriteti i hetimeve nëse kërkohet njoftimi sipas paragrafit 1.3.
3. Nëse prokurori vlerëson se njoftimi sipas situatave të referuara në paragrafin 1 paraqet rrezik për integritetin e hetimeve, prokurori bashkë me informatat e kërkuara sipas paragrafit 2 do të përfshijë një përshkrim të shkurtër mbi arsyen. Prokurori do të njoftojë Kryeprokurorin e tij i cili do të njoftojë Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit kur rreziku pushon të ekzistojë.
4. Në dosjen zyrtare të prokurorisë do të mbahet shënim mbi njoftimin e kërkuar sipas këtij neni.

Neni 5 Kërkesa për raportim të vazhdueshëm

Çdo prokuror ose Kryeprokuror që bën njoftimin sipas nenit 4 ose cilido prokuror që merr përsipër ndonjë çështje në të cilin është bërë një njoftim, do të jetë nën detyrimin e vazhdueshëm për të përcjellur njoftimet lidhur me ndryshimin e rrethanave kur baza për të bërë njoftimin sipas nenit 4 pushon të ekzistojë.

Neni 6 Detyrat e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

1. Jo më vonë se pesë (5) ditë pas pranimit të informatave të përcaktuara sipas nenit 4 dhe 5, Kryeprokurori i Shtetit ose i deleguari i tij do të dërgojë njoftimin kryesuesit të institucionit që punëson personin e identifikuar. Njoftimi do të përfshijë informatat në vijim:
 - 1.1 Vulën dhe logon e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
 - 1.2 Emrin e punonjësit;
 - 1.3 Veprat për të cilat dyshohet punonjësi, përfshirë edhe dispozitat përkatëse të Kodit Penal të Kosovës;
 - 1.4 Nëse është e zbatueshme, një vlerësim se prania e atij punonjësi paraqet rrezik për vazhdimësinë e hetimeve; dhe
 - 1.5 Nëse është e zbatueshme, një vlerësim mbi mbylljen e hetimeve, hudhjen e aktakuzës, apo çfarëdo vendimi tjetër për përfundimin e procedurës ndaj punonjësit.
2. Nëse punonjësi nuk është gjyqtarë apo prokurorë, por është punonjës i gjyqësorit apo prokurorisë, njoftimi do të dërgohet KGjK-së, respektivisht KPK-së.
3. Nëse njoftimi i Kryeprokurorit të Shtetit apo të deleguarit të tij përfshin njoftimin nga neni 4, par.3, Kryeprokurori i Shtetit apo i deleguari i tij nuk do të njoftojë institucionin derisa rreziku të pushojë të ekzistojë.
4. Kryeprokurori i Shtetit apo i deleguari i tij do të mbajë dokumentet e paraqitura në përputhje me nenin 4 dhe 5, bashkë me bazën e të dhënave e cila do të përfshijë informatat si në vijim:
 - 4.1 Emrin e prokurorit;
 - 4.2 Emrin e punonjësit, pozitën e tyre dhe institucionin;

4.3 Datën dhe llojin e njoftimit përkatës;

4.4 Veprën penale për të cilën dyshohet, dhe

4.5 Çfarëdo veprimi të ndërmarrë nga institucioni, nëse është i ditur.

Neni 7 Masat disiplinore

Lëshimi i prokurorit për të respektuar këtë rregullore mund të jetë bazë për fillimin e procedurës disiplinore.

Neni 8 Tranzicioni

Dispozitat e njoftimit për të gjitha rastet që janë në procedim e sipër dhe që kërkojnë njoftim sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje do të zbatohen brenda 60 ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga KPK.

Prishtinë, më 22 prill 2016

Blerim Isufaj
Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës

